



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2467/2 prot.,

Datë 10.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.**

Ankimues:

“Distributor of Medical Devices Group” SHPK me NIPT L81422033E dhe adresë *Adresa: Njësia nr. 8, Rruga Siri Kodra, Objekti nr. 198-Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal Vlorë

Adresa: Lagjia “Partizani”.

Në datën 09.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2023/3479 dhe me nr. 2467/2023 prot., datë 09.10.2023 e operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Sipas deklaratës së origjinës OE “Distributor of medical Devices Group “sh.p.k ka deklaruar për: Në vetëdeklarim tuaj në lidhje me deklaratën e origjinës së mallit ka mospërputhshmëri juridike edhe llogjistike për arsyet e mëposhtme:

Në këtë rast nuk bëhet lidhja midis certifikatës së konformitetit edhe artikujve

Artikulli 11 “Zhgute (llastik) për shtrëngimin e krahut ku do të merret gjaku se kompania prodhuese është kompania Syntesys srl por certifikata e konformitetit është për tuba dhe jo për zhgut. Katalogu është i kompanisë APTACA dhe produkti është produkt i prodhuar nga kompania APTACA dhe jo nga kompania Syntesys srl

→ Artikullin 10 “Gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjës (lancet)

→ kompania prodhuese është kompania gjermane Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH dhe deklarata CE e konformitetit është për produktin e prodhuar prej saj ,

→ Ndërkohë në katalog është paraqitur për këtë artikull katalogu i firmës APTACA edhe pse kompania gjermane ka lëshuar autorizim prodhuesi për firmën APTACA

→ ky autorizim deklaron se APTACA do të shes, komercializuar dhe promovuar produktet e tij pra nuk deklaron se ky produkt me markën APTACA janë produkte të prodhuara nga kompanie Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH

edhe për artikullin e mëposhtëm është paraqitur deklaratë e origjinës së mallit e një kompanie edhe katalogu i një firme tjetër si më poshtë :

→ Artikullin 13 “Age flutur për marrjen e gjakut “se kompania prodhuese është kompania kineze Yangzhou Medline Industry Co.Ltd. për të cilën ka paraqitur edhe certifikatën e konformitetit por katalogu është paraqitur i firmës APTACA.

→ Kompania kineze ka lëshuar autorizim prodhuesi për firmën APTACA ky autorizim deklaron se APTACA do të shes, komercializuar dhe promovuar produktet e tij, dhe jo të deklaroj se ky produkt me markën APTACA janë produkte të prodhuara nga kompania Yangzhou Medline Industry. Nuk ka dokumentacion që verteton lidhjen midis kompanisë RAYS“ me kompaninë kineze Yangzhou Medline Industry

→ Artikulli 9 “Shiringë për marrje gjaku me litium heparinë “se kompania prodhuese është kompania kineze Changzhou Chuangjia Medical appliance Co.Ltd dhe deklarata CE konformitetit është për produktin e prodhuar prej saj.

→ Katalogu është paraqitur i firmës APTACA për të cilën kompania kineze ka lëshuar autorizim prodhuesi ku autorizon APTACEN të shes, komercializuar dhe promovuar produktet e importuara nga RAYS S.p.A me kod artikulli HN22G32. Në certifikatën CE të kompanisë Changzhou Chuangjia Medical kodi është deklaruar 12748.

Duke qenë se produktet janë të importuara kodi duhet të jetë i njëjtë.

Referuar autorizimit që aptaca ka lëshuar për këtë procedurë prokurimi në cilësinë e anëtarit të kvo neni 82 « Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave» pika 2 ku citohet : Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë. duke qenë shumë e paqartë sesi ishte kjo lidhje juridike i jam drejtuar Aptaces Itali në adresën zyrtare të e-mailit të saj (pjesë e dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe përgjigja e saj në email sqaronte që i vetmi distributor në Shqipëri eskuziv është Gamma shpk.

Në këtë situatë i jemi drejtuar për sqarim edhe operatorit ekonomik, dhe pas këtij email Aptaca ridergon edhe një autorizim tjetër për . “Distributor of Medical Devices Group” por jo të firmosur nga përfaqësuesi zyrtar duke pranuar që ka qenë një gabim nga ana e tyre se përveç Gamma shpk autorizim i kanë dhënë edhe operatorit ekonomik“ Distributor of Medical Devices Group”.

Ridergohet kërkesa që ky lapsus sipas një operatore telefonike të korrigjohet me firmën zyrtare të përfaqësuesit ligjor të aptaca.

Por është refuzuar dhe në këto kushte si anëtar i KVO-së e quaj të pavlefshëm këtë autorizim”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 10.10.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri